

**KËRKESË**  
**Nr. 1307, datë 27.2.2019**  
**PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIM KONSULENCE**  
**“Ekspert prokurimi”**  
**Konsulent Individual Lokal - Ref. No. SAMP/CS/IC/02-2019**

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)*

*Hua No.: 8841- AL*

*Nr. i identifikimit të projektit: P162079*

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim shtesë nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (“Shërbim”) së kërkuar është **“Ekspert prokurimi”**.

Termat e detajuara të Referencës (TOR) për këtë shërbim gjenden në faqen e internetit si vijon:  
<http://www.shendetesia.gov.al/kerkesa-per-shprehje-interesi/>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit SAMP fton të gjithë konsulentët legjitimë (“Konsulentë”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion ku të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimin e kërkuar.

Kriteret e shortlistimit janë:

|                                   |                 |
|-----------------------------------|-----------------|
| 1. Kualifikimet e përgjithshme    | 30 pikë         |
| 2. Eksperienca të ngjashme        | 40 pikë         |
| 3. Aftësia për të kryer shërbimin | 30 pikë         |
| <b>Totali</b>                     | <b>100 pikë</b> |

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në seksionin III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17 të “Rregullave të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI-së”, të datës korrik 2016 (“Rregullat e Prokurimit”).

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhje sipas konsulencës individuale (IC), në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregullat e Prokurimit.

Konsulenti do të kontraktohet me kohë të plotë pune për periudhën që fillon nga shkurti 2019 dhe vazhdon deri më 30 qershor 2021.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00-16:30 nga e hëna deri të enjten dhe 08:00-14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **13 mars 2019**.

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)**

**Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)**

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – Kati I,**

**“Rruga e Kavajës”, nr. 53, AL. 1001, Tiranë, ALBANIA**

**Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli**

**e-mail: [samp.papadhopulli@gmail.com](mailto:samp.papadhopulli@gmail.com)**